



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Inspeksionit
Periudha Raportuese	Tetor, 2019
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Adelina Ademi

1. PËRMBLEDHJE

Gjatë muajit tetor 2019, mbarëvajtja e punëve ishte në nivelin e duhur, me përjashtime të emergjencave eventuale të paparashikuara dhe dinamikës së punës.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Aktivitetet e planifikuara për periudhën raportuese:

- Organizimi dhe koordinimi i punëve brenda sektorit;
- Ndarja e punëve dhe detyrave të punës, si dhe kujdesi për angazhimin e plotë të punëtorëve brenda sektorit;
- Njoftimi me udhëzime dhe urdhëresa lidhur me punën në kuadër të sektorit;
- Mbikëqyrja për kryerjen e rregullt të punëve, në përputhje me ligjin dhe aktet tjera;
- Përcjellja e gjendjes në kuadër të sektorëve, identifikimi i problemeve dhe vështirësive, si dhe propozimi i masave për mënjanimin e tyre;
- Përgatitja e planeve dhe raporteve ditore, javore dhe mujore të punës;
- Monitorimi i deponive ilegale në territorin e Prishtinës.

- Vizita nëpër objekte, për të cilat kemi pasur njohuri se nuk i zbatojnë rregullat, si dhe vërejtjet paraprake ambientale;
- Inspektimi i transportit publik;
- Inspektimi i lokaleve afariste sa i përket kushteve sanitare dhe tejkalimit të orarit të punës;
- Inspektimi i lokaleve afariste në lidhje me çështjen për konsumim të duhanit brenda ambienteve ku është e ndaluar pirja e duhanit etj.;
- Mbledhja e taksës komunale për shfrytëzim të hapësirës publike etj.;
- Aksione në vazhdimësi në transportin publik;
- Aksione në vazhdimësi për shitës ambulante;
- Kontrollimi i terrenit;
- Ndërprerja e të gjitha ndërtimeve pa leje;
- Kontrollimi sistematik i objekteve me leje;
- Inspektimi final i objekteve ndërtimore;
- Rrënimi i objekteve pa leje.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Ndërtim:

- Kontrollimi i terrenit;
- Ndërprerja e të gjitha ndërtimeve pa leje;
- Kontrollimi sistematik i objekteve me leje;
- Rrënimi i objekteve pa leje;
- Fletëthirrje -104;
- Procesverbale – 124;
- Aktvendime për ndërprerje të punëve – 31;
- Aktvendime për rrënim –12;
- Aktvendime për kthim në gjendje të mëparshme – 0;
- Gjoba mandatore – 26;
- Gjithsej shuma e përgjithshme e gjobave – 10.900 €;
- Gjoba të paguara – 10, në shumën prej 4.150 €;
- Gjithsej shuma e gjobave të papaguara – 16, në shumën prej 6.750 €;
- Kallëzime penale drejtuar Gjykatës Themelore – 0.

Pvlltaria:

- Konfiskimi 23.50 m³ dru;
- Kërkesat të rregullta për prerjen e pyjeve private – 90;
 - Kërkesa të shqyrtuara nga APK -0,
 - Numri i lejeve të lëshuara -2;
- Fletëparaqitje për kundërvajtje - 10;
- Fletëparaqitje penale – 0.

Rendi komunal:

- Lëndë të pranuar – 159;
- Procesverbale – 64;
- Lëndë të iniciuara për gjykatë – 0;
- Ankesa -15;
- Kërkesa – 16;
- Kërkesë për lirim të tregut të punës – 0;
- Kërkesë për asgjësim të mallit – 4;
- Kërkesë për zhvarrosje – 0;
- Dëmtim i gypit të ujësjes – 4;
- Gropim dhe dëmtim i rrugëve dhe hapësirës publike – 1;
- Hedhje e dheut dhe mbeturinave – 4;
- Inspektim-mbikëqyrje higjienë-sanitare, pajisja me pëlqim sanitar – 18;
- Pëlqime sanitare – 39;
- Inspektim i produkteve ushqimore (furra buke), afatet e përdorimit – 16;
- Konstatime – 2;
- Mosrespektim i rendit të udhëtimit – 0;
- Ndotje e rrugës – 2;
- Dëmtim i hapësirës publike të gjelbëruar – 2;
- Rrjedhje uji – 7;
- Shfrytëzim i hapësirës publike pa leje përkatëse – 16;
- Ekspozim i mallit – shitës ambulante – 2;
- Taksi pa leje pune – 12;
- Gjoha mandatore – 24(gjithsej);
- Aktpërcjellës për përmbarim të gjobës – 1;
Plane operative në transport publik dhe shitësve ambulante në vazhdimësi;
- Ftesa në GJKK – 0.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Sektori i pylltarisë:

- Hartimi i raporteve për muajin tetor 2019 dhe dërgimi i tij në Agjencinë e Pyjeve të Kosovës;
- Llogaritja e fletëparaqitjeve, inicimi i procedurave gjyqësore dhe procedimi i tyre nëpër gjykata kompetente, si dhe kontaktimi me gjyqtarë për harmonizimin e dispozitave ligjore;
- Kontrollimi i terreneve pyjorë dhe transportimi i masës drunore;
- Mbështetja dhe shpjegimi i procedurave për aplikim të marrjes së lejes për shfrytëzimin e pyjeve private;
- Pranimi i palëve, e aktivitete të tjera;
- Kontaktim dhe bashkëpunim me drejtorinë koordinuese të APK-ës (Planet e menaxhimit të pyjeve për vitin 2019) etj.

Sektori i rendit komunal:

- Kontrole dhe inspektime në terren në vazhdimësi nga ana e inspektorëve;
- Aksione në vazhdimësi në transportin publik dhe për shitës ambulante;
- Inspektim të hapësirave publike;
- Inspektim –mbikëqyrje të bizneseve të ndryshme për plotësim të kushteve teknike higjiene – sanitare;
- Inspektim - mbikëqyrje të marketeve për produkte ushqimore pa afat.

Sektori i ndërtimit:

- Kontrollimi i terrenit;
- Ndërprerja e ndërtimeve pa leje të evidentuara;
- Kontrollimi sistematik i objekteve me leje;
- Rrënimi i objekteve pa leje;
- Inspektimi final i objekteve ndërtimore.

5. STATISTIKAT

5.1. Takimet me palë

Të dhënat e mëposhtme janë relative:

Spektori i ndërtimit –

Spektori i pylltarisë – 20,

Spektori i Rendit komunal – 106,

Kabineti i drejtorit – 30.

5.2. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër:

Rendi komunal

- Lëndë të kryera – 14;
- Lëndë në procedurë – 124;
- Njoftime nga drejtoritë tjera – 21;
- Kërkesa nga GJTHDK për plotësim adrese – 0;
- Pezullime nga gjykatat – 64;
- Hedhje poshtë nga gjykatat – 8;
- Dënime nga gjykatat - 5;
- Fletëthirrje nga Gjykata Themelore në Prishtinë - 7;
- Aktvendim pezullues për mungesë provash – 0;
- Verifikim adrese – 4;
- Aktvendim me të cilën është shpallur jo kompetent gjykata themelore – 1.

Spektori i ndërtimit

- Ankesa – kërkesa të qytetarëve - 167;
- Kërkesa për inspektim final - 6;
- Të shqyrtuara janë – 4;
- Aktpërcjellëse në drejtoritë përkatëse – 4;
- Ankesa – kërkesa të pashqyrtuara (në procedurë) – 55;
- Lëndët gjatë muajit - 66;
- Të bartura nga viti paraprak – 10;
- Gjithsej ndërtime (renovime) të evidentuara – 56;
- Lëndë në procedurë të lejes – 36;
- Me leje ndërtimore, pëlqime – 30.

Spektori i pylltarisë

- Të hyrat nga pyjet private – 1,299.23 €;
- Të hyrat nga pyjet publike – 00 €;
- Gjithsej - 1,299.23 €.

6. SFIDAT

Sfida për këtë drejtori janë:

- Mungesa e planeve rregulluese, që detyron qytetarët të tentojnë për ndërtime pa leje;
- Bazuar në raportimin e inspektorëve dhe diskutimet e shpeshta me ta për gjendjen në terren, kemi konstatuar se **shkeljet ligjore - ndërtimet informale**, shumë shpesh ndodhin edhe si pasojë e vonësës tonë (**INSTITUCIONEVE**), për të iu prirë proceseve me planifikim. Ato-planët diku mungojnë e diku janë në s'përputhje me gjendjen faktike në terren dhe si të tillë vështirë të realizueshme;
- Shumë shpesh qytetarët shprehen se kanë qenë dhe janë të gatshëm t'u nënshtrohen procedurave për t'u pajisur me leje përkatëse, por nga pamundësia për t'u pajisur me leje, në njërin anë, dhe nevojat e menjëhershme për banim (rritja e familjes, shtimi i kurorave, kërkesa për banim më kualitativ etj.) i bën ata të zgjedhin zgjidhjen e menjëhershme të banimit, qoftë edhe duke e shkelur ligjin;
- Shumë shpesh qytetarët deklarojnë se edhe si pasojë e problemeve pronësore (jo gjithmonë për fajin e tyre), nuk mund t'i nënshtrohen procedurave për t'u pajisur me leje përkatëse;
- Prandaj, nga sa u tha më sipër dhe duke konsideruar veten tonë (INSTITUCIONET) si shërbyes të qytetarëve, i propozojmë Zyrës ligjore të Komunës së Prishtinës, të shqyrtojnë mundësitë ligjore për hartimin e ndonjë **rregulloreje** ose ndonjë **akti tjetër administrativ**, që qytetarëve me kërkesa të tilla dhe në situatat e përshkruara më lart, t'u bëhet një **zgjidhje më e shpejtë** në ndërmjetkohën e prurjes së planeve të reja, revidimit të atyre ekzistuese dhe rregullimit të problemeve pronësore;
- Përvoja dhe praktika të tilla duhet të ketë, por edhe nëse nuk gjenden, Drejtoria e Inspeksionit - Sektori i ndërtimit, shpreh gatishmëri të plotë për bashkëpunim me Zyrën ligjore dhe me cilindo institucion tjetër;
- Sfidë për këtë drejtori janë kërcënimet e vazhdueshme dhe sulmet ndaj stafit, është sfidë për shkak se nuk ekziston mbështetje as shëndetësore, as financiare;
- Mungesa e stafit, numri shumë i vogël i inspektorëve shkakton pamundësi të efikasitetit në punë për dy arsye, e para, pamundësia e mbajtjes në kontroll të terrenit dhe, e dyta, identifikimi i lehtë i inspektorit dhe mbajtja nën presion të vazhdueshëm;
- Mungesa e automjeteve;
- Mungesa e aparateve fotografike;
- Lejet e lëshuara nga Drejtoria e Urbanizmit krijojnë konfuzion për shkak të mos përcaktimit të kuotave vertikale të fundimit të objekteve;
- Në mungesë të inspektorit komunal të autorizuar vetëm për banim në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit, sipas Ligjin nr. 04/L-134, për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi, ne nuk kemi arritur të zbatojmë këtë ligj dhe aktet nënligjore;
- Mënyra e shqyrtimit dhe trajtimit të objekteve me shkallë të lartë të rrezikshmërisë (objekte të banueshme dhe të pabanueshme), pas identifikimit nga inspektorët e ndërtimit gjatë kontrollit ditor, si dhe pas pranimit të kërkesat të shumta nga qytetarët që kemi pranuar në Drejtorin e Inspeksionit;
- Mungesa e lokacionit – Tregut për shitjen e masës drunore;
- Mungesa e automjeteve për terren;

- Mungesa e lokacionit dhe hapësirës për vendosjen dhe sigurimin e druve të konfiskuara;
- Mungesë e rojeve të pyllit për ruajtjen dhe mbrojtjen e terrenit;
- Pamundësia dhe nevoja për hapjen e 2, eventualisht 3 vendeve të reja pune për roje pylli;
- Prerësit ilegal të pyjeve, (recidivistë), të cilët janë të njohur për Policinë dhe Prokurorinë, por nuk merren masa adekuate për t'i parandaluar ata.

7. REKOMANDIME:

- Rritja e numrit të inspektorëve;
- Automjete për inspektim terreni;
- Aparatet fotografike;
- Sigurimi i kushteve për punë në zyrë nga aspekti teknologjik (kompjuterë, printerë etj.);
- Pagesa për rrezikshmëri;
- Sigurimi në rast fataliteti në punë;
- Furnizim me mjete dhe instrumente matëse.

8. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES:

- Obligimin e bizneseve për t'u pajisur me leje për shfrytëzimin e hapësirës publike;
- Largimi i deponive ilegale të mbeturinave;
- Largimi i mbeturinave inerte;
- Kontrollimi i sipërfaqeve të gjelbra publike;
- Mbikëqyrja e rrugëve rreth punishteve;
- Inspektim të transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave;
- Inspektim i lokaleve afariste, kushteve sanitare, varrosjes së kafshëve;
- Inspektim të dëmtimit të rrugëve;
- Inspektim të hapësirave publike etj.;
- Organizimi dhe koordinimi i punëve brenda sektorit;
- Ndarjen e punëve dhe detyrave të punës, si dhe kujdesi për angazhimin e plotë të punëtorëve brenda sektorit;
- Njoftimi me udhëzime dhe urdhëresa lidhur me punën në kuadër të sektorit;
- Mbikëqyrja për kryerjen e rregullt të punëve, në përputhje me ligjin dhe aktet tjera;
- Përcjellja e gjendjes në kuadër të sektorit, identifikimi i problemeve dhe vështirësive, si dhe propozimi i masave për mënjanimin e tyre;
- Përgatitja e planeve dhe raporteve javore, mujore dhe vjetore të punës;
- Inspektimi i lokaleve afariste sa i përket kushteve sanitare dhe tejkalimit të orarit të punës;
- Mbledhja e taksës komunale për shfrytëzim të hapësirës publike etj.;
- Aksione në vazhdimësi në transportin publik;
- Aksione në vazhdimësi për shitës ambulantë;
- Kontrollimi i terrenit;
- Ndërprerja e të gjitha ndërtimeve pa leje;

- Kontrollimi sistematik i objekteve me leje;
- Inspektim final i objekteve ndërtimore;
- Rrënimi i objekteve pa leje.